

---

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR  
"BENGAJ" SHPK**

---

# AKTII THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "BENGAJ" SHPK

## KREU I EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

### NENI 1 EMRI I SHOQËRISË

1.1 Sot, në Tiranë më datë 13/05/2024, unë i nënshkruari:

Izmir Bengaj, shtetas Shqiptar, lindur në Roskovec, më 22.06.1996, dhe mbajtes i kartes se identitetit me nr.personal J60622024F,

Themeloj këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin,

**"BENGAJ" Shpk** (Me poshte e quajtur **"Shoqeria"**)

### NENI 2 SELIA

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresen: **Rruga "Muhamet Gjollësja", pallati nr. 67/6, shkalla 1, apartamenti 1, Tirane.**

2.2 Ortaku mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjes për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi.

### NENI 3 KOHËZGJATJA

3.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtroje në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:



- Import-eksport, bizhuteri, ora te ndryshme, gure te cmuar, ar, argjend, medaljone si dhe artikuj te ndryshem industrial.
- Perpunim argjendi dhe ari, si unaza, varese, medaljone, zinxhire, vathe etj.
- Punime medalje, varese, unaza etj. Tregeti me pakice dhe shumice te bizhuterive te ndryshme, gureve te cmuar, orave, ar dhe argjend dhe artikujt e ndryshem industrial.
- Shitblerje per vete e per te trete e te gjithë llojeve te arit dhe argjendit, gureve te cmuar dhe artikuj te ndryshem industrial.

Shoqeria mund te kryeje edhe cdo lloj aktiviteti tjeter ndihmes dhe te nevojshem, qe ka lidhje te mjaftueshme me kete objekt aktiviteti dhe qe nuk ndalohet nga ligjet shqiptare ne fuqi. Gjithashtu, Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter biznesi i cili nuk eshte I ndaluar nga ligji i zbatueshem.

## **KREU II KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE**

### **NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË**

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100,000 Lekë, është përbërë nga 1 (një) kuotë:

Izmir Bengaj, shtetas Shqiptar, lindur në Roskovec, më 22.06.1996, dhe mbajtes i kartes se identitetit me nr.personal J60622024F ,zoterues i 1 (nje) kuote me 100% (njëqind përqind) dhe vlerë 100,000 leke.

Derdhja e kapitalit do te kryhet pas regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregtar, gjate fazes se zhvillimit te aktiviteti te Shoqerise.

### **NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETËT**

6.1 Transferimi i kuotave te kapitalit te Shoqerise mund te behet me shitje, trashegimi, ose me cdo menyre tjeter te parashikuar nga ligji.

6.2 Ne rast transferimi te kuotave tek persona te trete jashte Shoqerise, qoftë me shitje qoftë me dhurim, ortaku qe synon te transferoje kuotat duhet t'i komunikojë ortakeve te tjere vullnetin e tij me shkrim. Ortaket e tjere kane te drejten e parablerjes te kuotave te ortakeve, me kushte te barabarta, dhe duhet ta ushtrojne kete te drejte brenda 30 diteve nga marrja e komunikimit te vullnetit te ortakut per te transferuar kuotat.

6.3 Vlera e kuotes qe transferohet do te percaktohet nga nje ekspert i emeruar nga ortaket me marreveshje ose nga gjykata ne rast se ortaket nuk bien dakort.



**NENI 7**  
**BARRA MBI KUOTAT E KAPITALIT**

7.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rëndohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale

**KREU III**  
**ORTAKET E SHOQERISE, FINANCIMET**

**NENI 8**  
**ORTAKET**

8.1 Ortaku i shoqerise është:

Izmir Bengaj, shtetas Shqiptar, lindur në Roskovec, më 22.06.1996, dhe mbajtes i kartes se identitetit me nr.personal J60622024F ,zoterues i 1 (nje) kuote me 100% (njëqind përqind) dhe vlerë 100,000 leke.

**NENI 9**  
**ORGANET E SHOQERISE**

9.1 Organet e Shoqerise jane:

- a) Asambleja e Pergjithshme;
- b) Administratoret.

**Neni 10**  
**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

10.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise dhe merr vendime kur eshte mbledhur rregullisht.

10.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, ne perputhje me ligjin dhe me kete Statut jane te detyrueshme per te gjithë ortaket perfshire ata qe mungojne.

10.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji per shoqerite tregtare, ligje te tjera, dhe sa here eshte e nevojshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise.

10.4 Asambleja e Pergjithshme mbahet ne seline e Shoqerise ose ne çdo vend tjeter te shenuar ne njoftimin per mbledhje. Njoftimi per mbledhje i dergohet me shkrim te gjithë ortakeve jo me



vone se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren dhe rendin e dites se mbledhjes.

10.5 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nga administratoret. Thirrja e Asamblese se Pergjithshme mund te kerkohet edhe nga ortaku ose ortaket qe perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme.

10.6 Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te zakonshme e jashtezakonshme.

### **Neni 11 ASAMBLEJA E ZAKONSHME**

11.1 Asambleja e zakonshme mblidhet, çdo vit brenda gjashte muajve nga data e mbylljes se vitit financiar, per miratimin e raportit te administratoreve, inventareve dhe llogarive vjetore.

11.2 Vendimet merren me shumice te zakonshme te votave ne prani te ortakeve me te drejte vote qe zoterojne me shume se 50 % te kuotave.

11.3 Nese nuk arrihet kuorumi sipas pikes 11.2, Asambleja do te mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite. Ne rast se as ne mbledhjen e dyte nuk arrihet kuorumi, ortaket e pranishem ose rregullisht te perfaqesuar do te perbejne kuorumin.

### **Neni 12 ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME**

12.1 Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te jashtezakonshme sa here eshte e nevojshme per marrjen e vendimeve ne interes te Shoqerise.

12.2 Vendimet qe kane te bejne me (por pa u kufizuar vetem ne to): ndryshimin e neneve te Statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit, ndryshimin thelbesor te objektit te veprimtarise se Shoqerise, prishjen e Shoqerise konsiderohen vendime te jashtezakonshme.

12.3 Vendimet e jashtezakonshme merren nga Asambleja e Pergjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave ne prani te ortakeve qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave.

12.4 Nese nuk arrihet kuorumi sipas pikes 12.3, Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite. Ne rast se ne mbledhjen e dyte nuk arrihet kuorumi, ortaket e pranishem ose rregullisht te perfaqesuar do te perbejne kuorumin.

### **Neni 13 Pjesemarrja, Votimi dhe Perfaqesimi**

13.1 Secili ortak ka te drejten e pjesemarrjes dhe votimit ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak jane ne numer te barabarte me kuotat e zoteruara prej tij.



13.2 Secili ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjet e Asamblese nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete me autorizim. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njetin rend dite.

#### **Neni 14** **Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme**

14.1 Asambleja e Pergjithshme vendos per:

- a) percaktimin e politikave tregtare;
  - b) ndryshimin e Statutit;
  - c) emerimin dhe shkarkimin e anetareve te Keshillit te Administrimit dhe caktimin e shperblimit te tij/tyre;
  - d) emerimin dhe shkarkimin e likuidatori/eve dhe eksperteve kontabel te autorizuar dhe shperblimin e tyre;
  - e) mbikyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise;
  - g) miratimin e zmadhimit dhe zvogelimit te kapitalit te Shoqerise;
  - h) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - i) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/eve;
  - j) shperndarjen e fitimeve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
  - l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te Asamblese;
  - m) çeshtje tjetër te caktuar nga ligji ose nga ky Statut.
- n) Kërkesa për kredi bankare dhe / ose nënshkrimit të faturave, garanci ose garanci në favor të palëve të treta

#### **NENI 15** **FINANCIMI I SHOQËRISË**

15.1 Organi i Administrimit te Shoqërisë në përputhje me dispozitat në fuqi përvec rasteve të zmadhimit te kapitalit ka të drejte të kërkoje nga ortakët e Shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë

15.2 Financimet e mëtejshme të ortakeve në shoqeri do të jene me shperblim (interesa) apo pa shperblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të levrohen këto fonde.



## KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### NENI 16 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

16.1 Shoqëria administrohet nga nje Administrator ;

Hasan Bengaj, shtetas Shqiptar, lindur në Roskovec, më 15.05.2000, dhe mbajtes i kartes se identitetit me nr.personal K00515031O,

i cili emerohet nga ortaku i vetem i shoqerise për një periudhë 5 vjecare me të drejtë rizgjedhje.

Administratori shkarkohet nga detyra, ne çdo kohe, me vendim te zakonshem te Asamblese se Pergjithshme sipas Statutit te Shoqerise.

Administratori ka kompetencat dhe detyrat e meposhtme:

- a) mbikeqyr dhe zbaton politiken e biznesit te Shoqerise;
- b) perfaqeson Shoqerine;
- c) kujdeset qe Shoqeria te zbatoje ligjet dhe standartet e mbajtjes se llogarive;
- d) pergatit dhe nenshkruan bilancin dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- e) siguron qe deklaratat e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurise se biznesit dhe çdo deklarim tjeter i detyrueshem sipas ligjit ose statutit, jane bere siç duhet;
- f) siguron qe auditimi i librave dhe i te dhenave kryhet te pakten nje here ne vit nga eksperte kontabel te çertifikuar dhe raporti i llogaritaveve publike te çertifikuar t'i vihet ne dispozicion Asamblese se Pergjithshme;
- g) krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise;

16.2 Administratori mund te ndërmarrë apo të kërkoj kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë pervec atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakeve apo organeve të tjera të Shoqërisë.

### NENI 17 SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT

17.1 Shpërblimi i administratorit të shoqërisë do të percaktohet nga Ortaket.

**KREU V**  
**KONTROLI KONTABËL I SHOQËRISË**  
**VITI FINANCIAR DHE BILANCI**

**NENI 18**  
**KONTROLI KONTABËL**

18.1 Kontrolli i jashtem kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspert Kontabel të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Ortaket do të emerojne një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kërkohet në baze të ligjit.

**NENI 19**  
**VITI FINANCIAR**

19.1 Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti

**NENI 20**  
**BILANCI DHE REZERVAT**

20.1 Me mbylljen e secilit vit financiar Administratoret marrin masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur ne mënyrë që ortaket të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

20.2 Ortaket vendosin mbi ndarjen e dividenteëve që rezultojne si fitime sipas bilancit te miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma janë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.

20.3 Ortaket në cdo moment mund të vendosin krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

**KREU VI**  
**PRISHJA DHE NJOFTIMET**

**NENI 21**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

21.1 Në rastin e likuidimit te Shoqërisë do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

**NENI 22**  
**NJOFTIMET**



22.1 Të gjitha njoftimet kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nese ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre prane Administratoreve të Shoqërisë.

22.2 Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.

22.3 Në rastin kur një kuote zotërohet nga më shumë se një person të gjitha njoftimet do të drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

## **KREU VII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

### **NENI 23 LIGJI I ZBATUESHËM**

23.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt themelimi dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë Akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

23.2 Ky Akt hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, dhe pasi lexohet nga Ortaku themelues, firmoset si më poshtë prej saj.

**IZMIR BENGAJ**

Dzmir Bengaj  
